



VENDIM

Nr.77 Datë 16.10. 2009

**Për mosmiratimin e “Raportit të Auditimit të Humbjeve” të OSSH sh.a
per vitin 2008**

Në mbështetje të nenit 9, të Ligjit Nr.9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar, pikës 4.5, paragrafi i fundit i Deklaratës Rregullatore të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s nr.12 datë 03.03.2009, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 16.10.2009, pasi shqyrtoi “Raportin e Auditit të Humbjeve” të OSSH sh.a për vitin 2008 të paraqitur nga shoqëria OSSH sh.a, dhe relacionin e Drejtorive Teknike në ERE,

Konstatoi se:

Bazuar në “Raportin e Auditit të Humbjeve” të OSSH sh.a, për vitin 2008, dokumentat mbështetëse të paraqitura, si dhe në deklaratimet gjatë seancës dëgjimore, “Raportin e Auditit të Humbjeve” të OSSH sh.a, për vitin 2008, nuk vërteton nivelin e pretenduar prej tij për humbjet e përgjithshme në sistemin e shpërndarjes për vitin 2008,

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Të mos miratojë “Raportin e Auditit të Humbjeve” të OSSH sh.a, për vitin 2008.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë OSSH sh.a për këtë vendim.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

Ky vendim botohet ne Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
BUJAR NEPRAVISHTA



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
Bordi i Komisionereve



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIM

Nr.77 Datë 16.10. 2009

Për mosmiratimin e “Raportit të Auditimit të Humbjeve” të OSSH sh.a
për vitin 2008

Anëtarër e Bordit

	Pro	Kundër
Bujar Nepravishta	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Ardian Haçi	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Shkelqim Bozgo	_____	_____



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
Bordi i Komisionereve

